

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në buxhetin e Kosovës

Qershor 2020



Ndikimi i pandemisë COVID - 19 në buxhetin e Kosovës

Deklaratë mohimi:

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të Institutit GAP dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si qëndrim i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur

Origjinali është shkruar në shqip.

Ky publikim është mbështetur nga:



Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4, 10000 Prishtinë
+383 38 609 339
info@institutigap.org

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive 6

1. Hyrje 7

2. Kufizimet ligjore për menaxhim të buxhetit në kohë të krizave 8

3. Ndryshimet në buxhetin e Kosovës si pasojë e pandemisë COVID-19 10

3.1 Ndikimi i COVID-19 në buxhetin vjetor sipas planifikimeve të MF në dokumentin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2021-2023 13

3.2 Dallimet në projeksionet për ndikimin e krizës në buxhet sipas FMN-së dhe MF-së 19

4. Ndikimi i pandemisë në buxhetin e komunave 21

4.1 Shpenzimet e komunave nga Pako Fiskale Emergjente 24

5. Paket Fiskale Emergjente në Ballkanin Perëndimor dhe masat për rimëkëmbje 27

6. Përfundimi 32

Anekset 33

Aneksi 1. Projektet e reja kapitale në buxhetin e vitit 2020 33

Aneksi 2. Pako Fiskale Emergjente e Kosovës 42

Aneksi 3. Paket Fiskale Emergjente të vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor 44

Përmbledhje ekzekutive

Kosova hyri në krizën e shkaktuar nga COVID-19 me një borxh publik mjaft të ulët, mirëpo që nga aplikimi i rregullës fiskale në vitin 2014, këtë vit pritet që për herë të parë deficitit buxhetor të tejkalojë kufirin e lejuar. Megjithë tejkalimin e kufirit të deficitit, Kosova vazhdon që ta ketë nivelin më të ulët të borxhit publik në rajon. Rritja e deficitit buxhetor vije si pasojë e rënies së të hyrave, por edhe e rritjes së shpenzimeve ngase qeveria në detyrë miratoi një pako fiskale emergjente dhe një pako e dytë për rimëkëmbje ekonomike pritet që të miratohet nga qeveria e re. Përderisa pakoja e parë, në një pjesë ishte realizuar përmes transfereve buxhetore qeveritare, një pako e dytë buxhetore nuk do të mund të zbatohet pa rishikim të buxhetit në Kuvendin e Kosovës. Duke marrë parasysh që për miratim të kredive ndërkombëtare nevojiten 2/3 e votave të deputetëve të Kuvendit, adresimi i plotë i krizës ekonomike nuk do të mund të bëhet pa përkrahjen e këtij institucioni. Në rast të mos miratimit të kredive, shpenzimet publike do të bien dhe kjo do të përshpejtojë edhe më tutje rënien ekonomike. Në vitin 2020, Kosova pritet që t'i ketë shpenzimet më të ulëta publike si përqindje e Bruto Produktit Vendor (BPV).

Megjithë planifikimin për rritjen e shpenzimeve, kategoria e investimeve kapitale si një kategori e cila ndihmon në rritje më të shpejt ekonomike, do të ketë një rënie të theksuar krahasuar me planifikimin. Ashtu sikurse në nivelin qendror, pandemia pritet të ndikojë negativisht edhe në të hyrat e nivelit lokal. Komunitat do të dëmtohen në aspektin buxhetor përmes disa kanaleve si: a) ulja e grantit të përgjithshëm dhe grantit për kryeqytetin; b) rënies së të hyrave vetanake; dhe c) rënies së investimeve kapitale nga niveli qendror.

COVID-19 ka sjellur një situatë të rrallë ku mjete financiare të konsiderueshme të taksa paguesve në Kosovë përdoren për shpëtim të pjesërisht të bizneseve dhe punëtorëve në sektorin privat. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), në pakon emergjente, qeveria në mënyrë të drejtë kishte fokusuar masat për adresimin e krizës. Mirëpo, tashmë kur rregullat për ndihmë shtetërore ndaj sektorit privat janë pothuajse të pezulluara në Kosovë dhe në botë, kjo situatë sjell edhe rreziqe të reja për menaxhimin e buxhetit. Rritja e madhe e subvencioneve si një nga kategoritë më pak të rregulluara ligjrisht, mund të krijojë hapsirë për abuzim të parasë publike.

Qëllimi i këtij raporti është që të paraqes ndikimin e pandemisë COVID-19 në buxhetin e Kosovës, por edhe mundësitë dhe rreziqet që përmes shpenzimeve publike të bëhet rimëkëmbja ekonomike dhe sociale e shkaktuar kjo pandemi.

1. Hyrje

Me 28 shkurt 2020, Qeveria e Kosovës mori vendimin e parë për ndarje buxhetore me qëllim të parandalimit të një situate të emergjencës së shëndetit publik të shkaktuar nga pandemia COVID-19.¹ Rreth dy javë pas këtij vendimi, u paraqit edhe rasti i parë i infektimit me COVID-19 në Kosovë.² Ndërkohë, jashtë afateve të rregullta ligjore, qeveria miratoi projektbuxhetin për vitin 2020 dhe njëkohësisht edhe “Planin për gatishmëri dhe reagim kundër virusit korona” me vlerë buxhetore prej 10 milionë euro.³ Më 11 mars, filluan vendimet për masat e para për parandalimin e virusit korona. Këto masa përfshinin pezullimin e linjave ajrore dhe tokësore, ndalimin e hyrje-daljeve nëpër disa komuna, mbylljen e shkollave, bareve, qendrave tregtare, tregjeve, pezullimi i koncerteve dhe ngjarjeve sportive, si dhe reduktimin e stafit në sektorin publik.⁴ Përveç kufizimit të aktivitetit biznesor, në fund të muajit mars filluan edhe kufizimet e levizjes së qytetarëve.⁵ Të gjitha këto masa do të kishin efekte edhe në mirëqenien ekonomike të qytetarëve dhe funksionimin e sektorit privat.

Për të adresuar situatën ekonomike dhe sociale të krijuar si pasojë e masave për ndaljen dhe kufizimin e punës së shumicës prej bizneseve në sektorin privat, Qeveria e Kosovës miratoi Pakon Fiskale Emergjente me vlerë prej 179.6 milionë euro.⁶ Në aspektin buxhetor, Kosova hyri në këtë pandemi me një borxh publik mjaft të ulët - rreth 20 pikë përqindje më i ulët se borxhi i lejuar me ligj dhe kjo i lejonte hapësirë të konsiderueshme fiskale për adresim të krizës. Mirëpo, hyrja në kredi të reja dhe tejkalmi i rregullës për kufirin e deficitit buxhetor u pamundësuan si alternativë sepse koalicioni qeverisës pësoi votë mosbesimi në Kuvendin e Kosovës.⁷ Gjithashtu, për akomodim të pakos së lartëcekur në buxhet, duhej që të bëhej transferi i një shumë të konsiderueshme të buxhetit dhe për këtë do të ishte e nevojshme të përfshihet në disa raste edhe Kuvendi i Kosovës. Kufizim tjetër sa i përket krijimit të hapësirës buxhetore për adresimin e krizës ishte edhe përqindja shumë e lartë e buxhetit për investime kapitale që ishte vazhdim nga vitet e kaluara. Instituti GAP ka bërë një analizë sa i përket ndarjeve buxhetore para pandemisë COVID-19.⁸

Qëllimi i këtij raporti është që të paraqes ndikimin e pandemisë COVID-19 në buxhetin e Kosovës si dhe kufizimet dhe mundësitë ligjore që ka Qeveria e Kosovës për adresimin e krizës në aspektin buxhetor. Në pjesën e parë është bërë një rishikim i bazës ligjore lidhur me kufizimet dhe mundësitë e ekzekutivit sa i përket menaxhimit të krizës. Pastaj është paraqitur ndikimi i krizës në të hyrat, shpenzimet dhe deficitin fiskal të vitit 2020. Kjo pjesë gjithashtu përmban një përmbledhje të ndikimit të pandemisë në të hyrat buxhetore për muajt janar-maj 2020. Në një pjesë të ndarë analizohen edhe dallimet në projeksionet e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Ministrisë së Financave (MF) për ndikimin e pandemisë në buxhet. Pjesa tjetër e analizës ndikimin potencial të krizës në financat e komunave, projektet buxhetore të komunave për adresimin e krizës si dhe ndikimin e krizës tek projektet që realizohen nga ministritë në komuna. Në fund, janë paraqitur masat kryesore buxhetore për adresimin e krizës në Kosovë dhe disa masa nga shtetet tjera.

1 Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 4, Burimi: <https://bit.ly/2zHDurM>

2 Koha.net, Dy raste positive në Kosovë me koronavirus, Burimi: <https://bit.ly/3d0QSo9>

3 Qeveria e Republikës së Kosovës, Qeveria Kosovës ka miratuar Projektligjin për Buxhetin e vitit 2020, Burimi: <https://bit.ly/3021pNn>

4 Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 9, Burimi: <https://bit.ly/2Blwn3T>

5 Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 15, Burimi: <https://bit.ly/36MB0US>

6 Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimi i mbledhjes nr. 19, Burimi: <https://bit.ly/3cjkLjg>

7 Koha, Kalon mocioni i mosbesimit, bie Qeveria Kurti, Burimi: <https://bit.ly/2U7foNU>, qasur me 4 qershor 2020

8 Institutit GAP, Prioritetet e buxhetit të Kosovës para pandemisë COVID-19, Burimi: <https://bit.ly/2XYnvOI>

2. Kufizimet ligjore për menaxhim të buxhetit në kohë të krizave

Në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike, Qeveria dhe Ministria e Financave kanë një sërë kompetencash por edhe kufizimesh sa i përket shkurtimeve dhe transfereve buxhetore për menaxhimin e shpenzimeve të paparashikuara. Në situatë kur ka ndonjë tronditje makroekonomike, siç është kjo me krizën e COVID-19, apo në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore, me miratimin e qeverisë dhe duke përjashtuar fondet nga të hyrat vetanake, Ministri i Financave mund të reduktoj fondet e alokuara për ndarje apo projekte sipas buxhetit për vitin 2020.⁹ Përmes kësaj mundësie ligjore, MF mund të krijojë fonde për financim të masave fiskale, mirëpo për transferimin e tyre ka disa kufizime.

Me kërkesë të udhëheqësve të organizatave buxhetore, Ministri/ja e Financave dhe Qeveria mund të transferojnë vetëm 15 deri 25% të ndarjeve buxhetore nga një kategori në tjetrën dhe duke përjashtuar transferin në kategorinë e pagave dhe medijëve.¹⁰ Në kategorinë e investimeve kapitale ekziston edhe një kufizim shtesë. Në rast të riallokimit të shumave brenda projekteve të ndryshme kapitale, atëherë ato duhet të bëhen vetëm në nën-programin e njëjtë.¹¹ Mirëpo, për çdo transfer buxhetor që e tejkalon këtë përqindje apo në rast të ndonjë transferi buxhetor ndërmjet organizatave buxhetore, atëherë nevojitet aprovim nga Kuvendi i Kosovës.¹² Gjithashtu, për çdo projekt të ri kapital, kërkohet një miratim nga kuvendi. Duke shfrytëzuar këto mundësi ligjore, MF ka menaxhuar një pjesë të Pakos Emergjente Fiskale, mirëpo për shkak të kufizimeve, kjo pako nuk do të mund të menaxhohet tërësisht pa përfshirjen e kuvendit.¹³

Ministri/ja mund të shmang kufizimet e cekura më lartë në rast se gjatë tre-mujorit të fundit të vitit, organizatat buxhetore kanë nën-shpenzime krahasuar me planin e rrjedhës së parasë. Në këtë rast, me arsyetim nga organizata buxhetore dhe aprovimin e qeverisë, mundet që mjetet e shkurtuara buxhetore t'i bartë brenda po të njëjtës organizatë apo edhe në organizatat tjera.¹⁴ Mirëpo, këto mjete nuk mund të barten për projekte të reja kapitale, nuk duhet të tejkalojnë 5% të vlerës totale të ndarjeve buxhetore dhe përjashtohen të hyrat vetanake, të hyrat e dedikuara dhe huamarrjet.¹⁵ Ministri/ja gjithashtu mund të shmang kufizimet në rastin e transferit të kontigjencave në MF dhe shuma e kësaj kontigjence këtë vit është 36.8 milionë euro.

Përderisa qeveria mund të transferoj mjete deri në 25% të një kategorie buxhetore, për çdo transfer që tejkalon 25% të një ndarje buxhetore të institucionit përkatës nevojitet përfshirja e kuvendi. Kuvendi nevojitet edhe për miratim të marrëveshjeve të reja kreditore dhe tejkallim të rregullës për kufirin e deficitit. Deficiti buxhetor në planfikimin e buxhetit për vitin 2020 është 2% e BPV-së që është njëkohësisht edhe maksimumi i lejuar i kufirit

9 Ligji për menaxhimin e financave publike, Neni 36

10 Ligji për menaxhimin e financave publike, Neni 30

11 Ligji nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Neni 16

12 Ligji nr. 07/L-001 Mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Neni 15

13 Intervistë me Ministrin e Financave z. Besnik Bislimi, 15 maj 2020

14 Këtu përjashtohen mjetet nga të hyrat vetanake, të hyrat e dedikuara dhe huamarrjet

15 Ligji nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Neni 15, paragrafi 3

të deficitit buxhetor.¹⁶ Për tejkalimin e këtij deficiti, Qeveria e Kosovës duhet t'i propozojë Kuvendit të Kosovës hyrjen në kredi të reja dhe rritjen e kufirit të deficitit buxhetor.¹⁷ Rritja e deficitit nuk duhet të tejkalojë ndikimin e ngjarjeve në periudhën relevante. Për dallim të rritjes së kufirit i cili mund të miratohet me shumicë të thjeshtë votash në kuvend, për miratimin e kredive të reja nevojiten 2/3 e votave të anëtarëve të kuvendit.¹⁹

Pa marrë parasysh lejimit për rritjen e deficitit buxhetor, buxheti i nënshtrohet edhe Ligjit për borxhin publik i cili nuk lejon rritjen kryegjësë së borxhit të përgjithshëm mbi 40% të BPV-së. Mirëpo, edhe pse planifikohet rritje e kufirit të deficitit, në periudhën afatmesme borxhi i përgjithshëm pritet të jetë rreth 27% e BPV-së apo rreth 13 pikë përqindje nën kufirin e lejuar.²⁰ Gjithashtu, edhe pas rritjes së parashikuar të këtij borxhi, Kosova pritet ta ketë borxhin më të ulët publik në rajon.²¹ Sipas programit të qeverisë, kufiri i borxhit të përgjithshëm pritet të rritet nga 40 në 50% në tri vitet e ardhshme.²²

● ● Ministri/ja e Financave dhe Qeveria mund të transferojnë vetëm 15 deri 25% të ndarjeve buxhetore nga një kategori në tjetrën dhe duke përjashtuar transferin në kategorinë e pagave dhe meditive.

16 Ligji nr. 04/L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L- 221 dhe nr. 04/L-116, neni 22A

17 Ibid, Neni 22B

18 Në rast se në një periudhë prej gjashtë muajsh të hyrat nominale tatimore janë më të ulëta se në periudhën e njëjtë të viti fiskal paraprak, Qeveria mund t'i propozojë Kuvendit tejkalimin e deficitit buxhetor.

19 Kushtetuta e Kosovës, Neni 18,

20 Ligji Nr. 03/L – 175 për borxhet publike, Neni 5

21 Western Balkans Regular Economic Report, No.17 | Spring 2020, The Economic and Social Impact of COVID-19, Burimi: <https://bit.ly/30zlyx>

22 Qeveria e Kosovës. Programi Qeverisës 2021-2023, Burimi: <https://bit.ly/2zshe4R>

3. Ndryshimet në buxhetin e Kosovës si pasojë e pandemisë COVID-19

Të hyrat buxhetore të Kosovës në periudhën janar-maj 2020 sipas të dhënave të MF²³ ishin rreth 621 milionë euro apo 106 milionë euro (14.6%) më të ulëta se në periudhën e njëjtë të vitit 2019.²⁴ Kurse vetëm në periudhën mars-maj 2020, që paraqet periudhën e pandemisë COVID-19 kur edhe ishin ndaluar shumica e aktiviteteve në sektorin privat dhe atë publik në Kosovë, të hyrat buxhetore ishin 337 milionë euro apo 133 milionë euro (28.2%) më të ulëta se në periudhën mars-maj 2019. Këto të dhëna tregojnë që rënia në të hyrat buxhetore, siç edhe pritej, ishte shkaktuar në periudhën e pandemisë kur aktiviteti ekonomik ishte i vogël. Sikur kjo rënie në të hyra gjatë pandemisë të mos neutralizohej deri në një masë nga performanca e mirë gjatë muajve janar dhe shkurt, rreth 27 milionë euro më shumë se në vitin paraprak, atëherë rënia e të hyrave buxhetore në pesëmujorin e parë të vitit 2020 do të ishte edhe më e lartë.


Tek të hyrat buxhetore nga tatimet indirekte, që janë burim i rreth 80% të të hyrave vjetore, krahasuar me vitin paraprak, rënie prej mbi 59 milionë euro apo 29% në periudhën mars-maj 2020 ka tek të hyrat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH). Rënia është kryesisht tek TVSH e mbledhur në kufi (44 milionë euro). Të hyrat nga detyrimi doganor janë ulur për rreth 12.8 milionë euro apo 39%. Kurse, një rënie më të lehtë gjatë periudhës mars-maj 2020 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kanë pësuar të hyrat nga akciza për rreth 11.7 milionë euro apo 11%. Ndikim në rënie të hyrave nga tatimet indirekte në këtë periudhë kishte edhe rënia e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare. Edhe pse sasia e importuar e lëndëve djegëse ishte thajse e njëjtë, në prill të vitit 2020 raporti mes vlerës së këtyre produkteve dhe sasisë së importuar ishte 0.24 (euro/njësi), kurse në prill të vitit 2019 raporti ishte 0.52 (euro/njësi).²⁵ Po ashtu, një ndikim në rënie të hyrave nga detyrimi doganor e ka edhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) që parasheh përshkallëzim të përqindjes së aplikuar në mallrat që importohen nga Evropa. Mirëpo ndikimi i saj në këtë rënie, bazuar edhe në vitet e kaluara, duhet të jetë më i ulët se ai i pandemisë.

23 Bazuar në mesataren e nxjerrur nga të dhënat e vitit 2019.

24 Ministria e Financave. Thesari. Seritë fiskale mujore. Burimi: <https://bit.ly/37jucy>. Të dhënave të njëjta u jemi referuar edhe në pjesën vijuese.

25 Dogana e Kosovës. Bilanci Tregtar 2019-2020. Burimi: <https://bit.ly/2AuExeV>

Figura 1. Të hyrat buxhetore nga tatimet indirekte, mars-maj 2019-2020




BURIMI: INSTITUTI GAP DUKE PËRDORUR TË DHËNAT E MF

Tek të hyrat buxhetore nga tatimet direkte, rënie më të theksuar në periudhën mars-maj 2020 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kanë pësuar të hyrat nga tatimi në të ardhura të korporatave me rreth 11 milionë euro apo 37%. Ngjashëm, të hyrat nga tatimi në të ardhurat personale kanë rënë për rreth 8.7 milionë euro apo 20%. Po ashtu, tek tatimi në pronë janë ulur të hyrat për rreth 4.5 milionë euro apo 62%. Mirëpo, tek kjo kategori ndikim ka edhe vendimi i qeverisë për të ua shtyrë afatet për pagesën e tatimit në pronë qytetarëve.²⁶ Një pjesë e këtyre mjeteve mund të grumbullohen gjatë pjesës së mbetur të vitit, gjë që e neutralizon rënien totale vjetore të këtyre të hyrave.

26 Ministria e Financave. Vendimi nr. 20/2020. Burimi: <https://bit.ly/2ArIRvj>

Figura 2. Të hyrat buxhetore nga tatimet direkte, mars-maj 2019-2020




BURIMI: INSTITUTI GAP DUKE PËRDORUR TË DHËNAT E MF

Sa i përket shpenzimeve buxhetore në vitin 2020, konkretisht periudhën janar-maj, shpenzimet e gjithmbarshme nëpër kategoritë ekonomike kanë qenë 716 milionë euro apo për 14.1 milionë euro (2%) më të larta se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në bazë të kategorive ekonomike verëjmë së në periudhën janar-maj në nivel qendror janë rritur shpenzimet për paga dhe medijtje (17.7 milionë euro apo 12%), subvencionet dhe transferet (35 milionë euro apo 15%), ndërsa ka rënie tek mallrat dhe shërbimet (2 milionë euro apo 3%) dhe shpenzime kapitale (25.9 milionë euro apo 36%).

Në periudhën prej fillimit të pandemisë, shpenzimet nëpër kategori ekonomike ishin 485 milionë euro apo për 4.7 milionë euro (1%) më të ulëta se në periudhën mars-maj 2019. Tek niveli qendror, në periudhën mars-maj 2020, kur kishte filluar edhe ndërhyrja e qeverisë në ekonomi përmes Pakos Emergjente Fiskale, krahasuar me vitin paraprak vërehet rritje e kategorisë së subvencioneve dhe transfereve për mbi 34.3 milionë euro (22.6%), ku rritja është e ndikuar kryesisht nga kategoria e subvencioneve (26.1 milionë euro apo 91.1% rritje) dhe më pak nga ajo e transfereve sociale (8.2 milionë euro apo 6.6% rritje). Po ashtu, është rritur edhe kategoria e pagave dhe medijtjeve për 14.3 milionë euro apo 16.5%. Ndërsa, investimet kapitale janë përgjysmuar nga 71.5 milionë euro sa ishin në periudhën mars-maj 2019 në 34.8 milionë euro në vitin 2020. Ngjashëm, shpenzimet e komunalive kanë rënë për 792 mijë euro apo 18.6%.

Figura 3. Shpenzimet buxhetore nga niveli qendror, mars-maj 2019-2020



BURIMI: INSTITUTI GAP DUKE PËRDORUR TË DHËNAT E MF

3.1 Ndikimi i COVID-19 në buxhetin vjetor sipas planifikimeve të MF në dokumentin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2021-2023

Për të zbutur dëmet që u ka shkaktuar pandemia COVID-19 qytetarëve dhe bizneseve, ku një numër i madh i tyre kanë qenë të detyruar ta ndalin aktivitetin për më shumë se një muaj, Qeveria e Kosovës sikurse edhe shtetet tjera, ka miratuar një Pako Emergjente Fiskale. Pakoja e miratuar më 30 mars 2020 nga Qeveria e Kosovës, me një shumë prej rreth 179.6 milionë euro targeton qytetarët në gjendje më të rënduar ekonomike, punëdhënësit dhe punëmarrësit.²⁷

Në muajin prill 2020, Qeveria e Kosovës ka paraqitur propozimin për ndryshimin e buxhetit fillestar të vitit 2020 si rezultat i dëmeve të shkaktuara në ekonomi nga pandemia COVID-19.²⁸ Mirëpo, në dokumentin e KASH 2021-2023 të publikuar më vonë nga MF, ka pasur ndryshime në projeksionet rreth të hyrave dhe shpenzimet e buxhetit për vitin 2020, andaj të dhënat që do të analizohen në këtë raport janë ato të këtij dokumenti.²⁹ Konkretisht, në KASH 2021-2023 paraqiten projeksionet lidhur me ndikimin e gjendjes së krijuar në të hyrat vjetore nga rënia e aktivitetit ekonomik, mos realizimit të një pjese të investimeve kapitale, ndikimit në shpen-

²⁷ Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimi i mbledhjes nr. 19. Burimi: <https://bit.ly/3cjkLjQ>

²⁸ Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimi i mbledhjes nr. 23. Burimi: <https://bit.ly/2XQVajq>

²⁹ Ministria e Financave (2020). "Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023". Burimi: <https://bit.ly/2TDQOnQ>

zimet rrjedhëse, dhe më shumë. Siç do ta paraqesim mëposhtë, dallime ka edhe në mes të projeksioneve të MF-së në KASH dhe atyre të FMN-së.

Në projeksionet e MF të paraqitura në KASH 2021-2023 është paraparë nënshpenzim i buxhetit për investime kapitale dhe shpenzime për mallra dhe shërbime në vitin 2020 prej rreth 134 milionë euro. Po ashtu, është paraparë edhe rritje e borxhit për dallim nga ligji i buxhetit 2020 për rreth 257 milionë euro. Si rrjedhojë, aktualisht janë rreth 391 milionë euro buxhet i projeksionuar që mund të përdoret për mbulimin e kostos së masave në pakon emergjente dhe atyre të reja nga një Pako Fiskale e Rimëkëmbjes, si dhe mbulimin e shpenzimeve tjera të planifikuara në ligjin e buxhetit për të cilat nuk ka mjete të mjaftueshme për shkak të rënies së të hyrave buxhetore. Gjithsesi, qeveria ka hapësirë që të rialokojë dhe rrisë buxhetin për masa të tilla, meqë, në bashkëpunim me Kuvendin, ka mundësitë ligjore për rialokim edhe më të madh të buxhetit dhe rritje të financimit nga huamarrja.


Shpenzimet për vitin 2020 pritet të jenë rreth 2.38 miliardë euro, që janë për 25 milionë euro apo 1% më të larta se projeksioni në ligjin e buxhetit 2020. Sipas Bankës Botërore, në vitin 2020 Kosova pritet të jetë vendi me shpenzimet më të ulëta publike në rajon si përqindje e BPV-së.³⁰ Kurse, të hyrat janë projektuar të bien nga 2.02 miliardë euro sa ishin paraparë fillimisht, në rreth 1.79 miliardë euro në, pra rreth 232 milionë euro apo 12% më pak. Si rrjedhojë, nevoja për financim është rritur ndjeshëm, për rreth 257 milionë euro apo 76% më shumë se në ligjin e buxhetit për vitin 2020. Në terma relativë, deficitin buxhetor sipas rregullës fiskale për vitin 2020 do të jetë rreth 6.7% e BPV që paraqet tejkalim prej 4.7 pikë përqindje të kufirit për deficitin buxhetor të përcaktuar sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.³¹ Ndërsa, në Programin Qeverisës 2020-2023 të prezantuar nga qeveria e re, deficitin buxhetor është projeksionuar të jetë 6.5%, pra për 0.2 pikë përqindje më i ulët se në KASH 2021-2023. Duke marrë parasysh që kufiri fiskal pritet të devijojë për 4.2 pikë përqindje, atëherë rivendosja e kufirit duhet të vendoset brenda një periudhe pesë vjeçare.³² Mirëpo, në bazë të programit të qeverisë aktuale, rivendosja e kufirit pritet të ndodhë brenda tri viteve.

30 Western Balkans Regular Economic Report, No.17 | Spring 2020, The Economic and Social Impact of COVID-19, Burimi: <https://bit.ly/3Ozlzyx>

31 Ligji nr. 04/L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116, neni 22A

32 Ligji nr. 04/L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116, Neni 12

Figura 4. Financimi i buxhetit



Shuma e paraparë për investime kapitale sipas projeksioneve fillestare të paraqitura në KASH 2021-2023 është ulur nga 672 në 583 milionë euro, pra rreth 89 milionë euro apo 13% më pak. Arsye për uljen e buxhetit të shpenzimeve kapitale pritet të jenë vonesat në kryerjen e procedurave për disa projekte kapitale, për shkak të shkallës së ulët të aktivitetit ekonomik në kohën e pandemisë, por edhe për shkak të nevojës që disa mjete të barten për programet që mbulojnë ndonjëherë nga masat e Pakos Fiskale Emergjente. Niveli sesa do të ndikohen shpenzimet kapitale varet edhe nga forma e financimit të ndërhyrjeve në ekonomi nga ana e qeverisë si dhe koha e përfundimit të pandemisë. Niveli i realizimit të investimeve kapitale në përgjithësi ishte mjaft i ulët edhe para pandemisë. Në vitin 2019 ishin realizuar vetëm 68% e investimeve kapitale të planifikuara.³³

Aktualisht, sipas MF-së, tek investimet kapitale nga niveli qendror janë pezulluar të gjitha investimet e reja kapitale.³⁴ Nga gjithsej 51 milionë euro sa ishin paraparë për këto investime kapitale, institucioneve që do t'u ulet më shumë buxheti janë Ministria e Financave me 14.7 milionë euro, Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit (MIA) me 9.3 milionë euro, Ministria e Shëndetësisë (MSH) me 4.7 milionë euro, Universiteti i Prishtinës me 4.1 milionë euro, Ministria e Mbrojtjes me 3.2 milionë euro, si dhe disa institucione tjera.³⁵ Tek MF, këto mjete nuk përkrijnë me ndonjë investim kapital specifik, por bëhet fjalë për kontigjenca në vlerë rreth 13.2 milionë euro. Ndërsa, tek MIA, shumica e këtij buxheti ishte papraparë të investohet nëpër komuna ku projektet e ndikuara janë paraqitur në Figurën 10. Tek MSH, ndër projektet e pezulluara është ai për blerjen e paisjeve për departamentin e mikrobiologjisë me vlerë prej 1.2 milionë euro dhe skemat e pagesës së performancës për kapitation me buxhet prej 552 mijë euro. Kurse tek UP, do të ndikohen një numër i madh projektsh kapitale si për rinovimin e objekteve të fakulteteve dhe projekte të ngjashme infrastrukturore, kurse tek Ministria e Mbrojtjes do të mund të ndikohet projekti për sistemet e armatimit me vlerë rreth 3.2 milionë euro.

33 Ministria e Financave, Raporti vjetor financiar i buxhetit të Republikës së Kosovës 2019, Burimi: <https://bit.ly/2MUWBkR>

34 Radio Evropa e Lirë. Pandemia pezullon projektet e reja kapitale. Burimi: <https://bit.ly/2XAGD4t>.

35 Shih Aneksin 1


Figura 5. Projektet e reja kapitale të nivelit qendror



BURIMI: INSTITUTI GAP DUKE PËRDORUR TË DHËNAT LIGJIT TË BUXHETIT 2020

Në rast se burim primar i financimit do të jetë huamarrja, pra nëse aprovoen në kuvend marrëveshjet ndër-kombëtare që i ka negociuar qeveria – sikurse me FMN apo Bankën Botërore (BB) – dhe nuk kemi përsëri mbyllje të ekonomisë për shkak të virusit COVID-19, atëherë pezullimi i investimeve kapitale për vitin 2020 dhe rialokimi i mjeteve do të mund të ishte më i ulët. Mirëpo, bazuar në Programin Qeverisës 2020-2023 të prezantuar nga qeveria e re në qershor të këtij viti, theksohet se nënshpenzimet nga buxheti i vitit 2020 do të jenë 180 milionë euro, pra edhe më të larta se projeksionet e paraqitura në KASH 2021-2023.³⁶ Lidhur me burimin e financimit të shpenzimeve kapitale, ndryshimi i vetëm sipas KASH 2021-2023 është largimi i tërësishëm i financimit nga fondet e likuidimit nga AKP prej 85 milionë eurove. Në këtë situatë, mbi 87% e projekteve të investimeve kapitale do të jenë nga buxheti i rregullt.

Figura 6. Financimi i shpenzimeve kapitale




Vlera e shpenzimeve rrjedhëse në KASH është rritur në 1.77 miliardë euro apo 113 milionë euro (7%) më e lartë se në ligjin fillestar të buxhetit. Në kategorinë e shpenzimeve rrjedhëse, rritja buron kryesisht nga masat e Pakos Emergjente Fiskale për rritjen e kategorisë së subvencioneve dhe transfereve sikurse rritja e pensioneve, pagat shtesë për punonjësit e shëndetësisë, policisë, sektorit të shitjes, dhe më shumë.³⁷

³⁶ Qeveria e Kosovës, Programi Qeverisës 2020-2023


³⁷ Shih Aneksin 2

Figura 7. Ndryshimi në shpenzimet rrjedhëse dhe kapitale



Konkretisht, tek shpenzimet rrjedhëse, siç tregon Figura 8, kategoria e pagave dhe mëditjeve është projektuar të rritet për 15 milionë euro apo 2% krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2020, kategoria e mallrave dhe shërbimeve do të zvogëlohet për 49 milionë euro apo 14%, ndërsa kategoria e subvencioneve dhe transfereve do të rritet për 148 milionë euro apo 23%. Rritja e kategorisë së subvencioneve, sidomos në formë të ndihmës ndaj sektorit privat, përmban edhe rreziqe që këto mjete të mos përdorën për të mirën e përbashkët por për grupe interesi.³⁸

Figura 8. Rritja e shpenzimeve rrjedhëse




38 Transparency International, Getting ahead of the curve, Burimi: <https://bit.ly/3cZeRUV>

3.2 Dallimet në projeksionet për ndikimin e krizës në buxhet sipas FMN-së dhe MF-së

Për shkak të parashikimeve për rënie më të madhe ekonomike, të hyrat buxhetore të projektuara nga FMN-ja janë për rreth 111 milion euro më të ulëta se projeksionet e MF. Kjo, ngase FMN ka projektuar rënie më të mëdha në të hyrat tatimore e sidomos në tatimin mbi vlerën e shtuar ku ka projektuar për rreth 55 milion euro më pak të hyra.


Figura 9. Dallimet në mes të projeksioneve të MF-së dhe FMN-së (në miliona)



Sa i përket shpenzimeve, FMN ka paraparë rënie të shpenzimeve 374 milionë euro më pak krahasuar me projeksionet në KASH. Kjo rënie është projektuar për shkak të projeksioneve shumë më të ulëta, prej vetëm 199 milionë euro apo 384 milionë euro më pak se në KASH, tek shpenzimet kapitale. Në anën tjetër, FMN ka projektuar një rritje më të theksuar se MF, dallim prej 43 milionë euro, të shpenzimeve rrjedhëse për shkak të masave stimuluese fiskale të qeverisë.³⁹ Ndërsa FMN-ja ka projektuar vlerë shumë më të vogël të shpenzimeve kapitale.

39 Ministria e Financave (2020). "Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023". Burimi: <https://bit.ly/2TDQOnQ>

Figura 10. Dallimet në shpenzime sipas kategorive ekonomike (në miliona)




Duke marrë parasysh projeksionet e FMN-së për shpenzime më të ulëta se ato të MF-së, edhe deficieti buxhetor është projektuar të jetë më i ulët. Sipas FMN-së, deficieti i përgjithshëm buxhetor pritet të jetë 4.8% e BPV-së, ndërsa MF ka projektuar një deficit prej 8%. Dallime ka edhe sa i përket projektimit të financimit të deficitit. MF parashah financim më të madh të deficitit nga borxhi i jashtëm, ndërsa FMN nga ai i brendshëm.

4. Ndikimi i pandemisë në buxhetin e komunave

Rënia e të hyrave buxhetore do t'i ndikojë edhe të hyrat komunale, qoftë nga transferet qeveritare apo nga të hyrat e tyre vetanake. Si pjesë e transfereve qeveritare, granti i përgjithshëm për komuna përbën rreth 37% të të hyrave komunale. Duke qenë se ky grant kalkullohet mbi bazën e të hyrave nga niveli qendror, rënia e të hyrave në nivel qendror do të ndikojë automatikisht edhe në rënien e të hyrave për komuna. Gjithashtu, komnat do të ndikohen negativisht edhe nga rënia e të hyrave vetanake që përbëjnë rreth 18% të të hyrave komunale. Ndërsa, janë pezulluar edhe 10 milionë euro investime nga niveli qendror në komuna. Në anën tjetër, pandemia COVID-19 ka shkaktuar kosto shtesë për komuna, mirëpo këto shpenzime pritet të mbulohen nga Qeveria e Kosovës përmes një mase nga pako emergjente me vlerë 10 milionë euro. Instituti GAP ka kryer një analizë lidhur me efektet e gjithëmbarshme të COVID-19 në pushtetin lokal.⁴⁰

Në bazë të parashikimeve në KASH 2021-2023 dhe kalkulimeve të Institutit GAP, granti i përgjithshëm i komunave mund të bie për 24 milionë euro (17%) ndërsa të hyrat vetanake pritet të bien të paktën për 5 milionë euro. Pra në total, të hyrat e komunave mund të bien për 29 milionë euro (5%). Mirëpo, nëse bazohemi në parashikimet e FMN-së, të hyrat e përgjithshme të komunave mund të bien për 34 milionë euro (6%). Rënia e të hyrave në nivel qendror do ta ndikojë negativisht edhe në grantin për kryeqytetin, i cili mund të ketë një rënie prej një deri në dy milionë euro. Duke marrë parasysh se Komuna e Prishtinës është gjithashtu komuna me të hyrat më të larta vetanake, ndikimi i pandemisë mund të jetë më i theksuar tek kjo komunë.


Figura 11. Parashikimet për të hyrat komunale pas pandemisë (në miliona euro)



40 Instituti GAP, Ndikimi i pandemisë COVID-19 në pushtetin lokal, Burimi: <https://bit.ly/3fjRdEd>

Sa i përket investimeve kapitale që prekin komunat, janë pezulluar rreth 10 milionë euro investime të reja nga ministrinë.⁴¹ Pjesa më e madhe e projekteve që janë pezulluar, apo rreth 71%, janë investime kapitale të MIA në komuna. Ndërsa, 23% janë projekte kapitale të MKRS dhe 6% të MASHTI-t.


Figura 12. Investimet e reja kapitale të ministrive në komuna



Ndër projektet kryesore që ishin paraparë të realizohen nga MIA në komunat e Kosovës dhe që janë pezulluar janë ndërtimi i impianteve në komunat e Gjilanit (1 milion euro) dhe Ferizajt (500 mijë euro), zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në Vushtrri (750 mijë euro), ndërtimi i shtëpivë në pjesën veriore të Kosovës (500 mijë euro), dhe më shumë. Kurse, tek projektet e MKRS, projektet kryesore të pezulluara janë Ndërtimi i Qendrës Nacionale të Tenisit të Kosovës në Prishtinë (200 mijë euro) dhe Rivitalizimi i stadiumit në Pozheran në Viti (200 mijë euro). Nga projektet e MASHT do të preken ndërtimi i shkollës “Fan Noli” në Kamenicë (200 mijë euro) dhe ndërtimi i shkollës në Damjan në Gjakovë (169 mijë euro).


41 Instituti GAP bazuar në të dhënat e Ligjit të Buxhetit 2020.

Figura 13. Disa projekte kapitale qendrore të pezulluara në komuna




1,000,000 €

Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza në Gjilan



750,000 €

Zgjerimi i rrjetit të ujësjellsit në Vushtrri



500,000 €

Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Ferizaj



500,000 €

Ndërtimi i shtratit të lumit Mirusha në Gjilan



500,000 €

Ndërtimi i shtëpive në pjesën veriore të Kosovës



500,000 €

Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica në Vushtrri



400,000 €

Ndërtimi i argjinaturave të lumit nga ura e tranzitit deri në Zahaq në Pejë



300,000 €

Palestra sportive në Lipjan



300,000 €

Ndërtimi i urës në rrugën Nationale N9, segmenti Pejë - Kuqishtë, lokacioni Drelaj



250,000 €

Furnizim me ujë në fshatrat e lugut të Baranit



200,000 €

Ndërtimi i Qendrës Nationale të Tenisit të Kosovës në Prishtinë



200,000 €

Rivalizimi i Stadiumit në Pozheran në Viti



200,000 €

Ndërtimi i shkollës fillore "F.Noli" në Kamenicë



168,902 €

Ndërtimi i shkollës në Damjan në Gjakovë

4.1 Shpenzimet e komunave nga Pako Fiskale Emergjente

Siç u përmend më lartë, për adresimin e shpenzimeve të komunave nga COVID-19, Qeveria e Kosovës ka hartuar një masë të veçantë. Masa numër 5 e pakos fiskale emergjente u ofron komunave të Republikës së Kosovës një mbështetje shtesë financiare deri në 10 milionë euro.⁴² Si kriter për alokim të shumës së buxhetuar për komuna është numri i banorëve për komuna, mirëpo komunat e prekura më shumë nga pandemia do kenë edhe diskriminim pozitiv. Shpenzimet për COVID-19, fillimisht do të financohen nga komunat nga projektet e tyre kapitale të planifikuara për 2020 dhe të hyrat e bartura, dhe më pas do të rimbursohen nga Ministria e Financave.

Deri në mes të muajit maj 2020, komunat kanë buxhetuar rreth 3.9 milionë euro në këtë kod buxhetor. Nga mjetet e buxhetuara, omunat kanë shpenzuar gjithsej 58% (2.3 milionë euro). Shumica e mjeteve të buxhetuara (2.4 milionë euro) janë buxhet për shëndetësi dhe prej të cilave janë shpenzuar 1.7 milionë euro. Në arsim, komunat kanë buxhetuar rreth 42 mijë euro ndërsa nuk kanë realizuar ende shpenzime. Pjesa tjetër e buxhetit është ndarë për shtesa për inspektorate dhe administratë. Mirëpo, një pjesë e vogël e këtij buxheti parashihet të shpenzohet për mallra dhe shërbime dhe paga për programin e infrastrukturës rrugore. Në bazë të klasifikimit ekonomik, nga 45% e buxhetit do të shkojë në paga dhe mëditje dhe mallra dhe shërbime, ndërsa 10% në subvencione dhe transfere.


Figura 14. Shpenzimet nga fondi emergjent për komuna



Komuna e Gjilanit renditet e para sa i përket mjeteve të buxhetuara me 323 mijë euro, ndërsa ka shpenzuar më shumë se 226 mijë euro. Komuna e Prishtinës renditet e dyta për nga buxhetimi me 249.2 mijë euro dhe e para për nga shpenzimi, duke shpenzuar në tërësi atë që ka buxhetuar. Drenasi është komuna e tretë me buxhetimin më të lartë dhe renditet e 16-ta në shpenzim, e kështu me radhë.

42 Qeveria e Kosovës, Vendim nr 31/2020, Burimi: <https://bit.ly/2M7xLOg>


Figura 15. Shpenzimet e komunave për COVID-19



● Shpenzim ● Buxhetim

Në periudhën janar-maj, shpenzimet e komunave kanë rënë për 13.6 milionë euro apo 10.5%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Nëse krahasojmë shpenzimet e komunave në bazë të kategorive ekonomike për periudhën mars-maj 2019, shohim se pagat janë rritur për rreth 4 milionë euro apo 6%, dhe mallrat dhe shërbimet për 612 mijë euro apo 3%. Tek kategoritë tjera ekonomike ka rënie krahasuar me periudhën mars-maj 2019. Konkreisht, shpenzimet kapitale kanë rënë për rreth 9.6 milionë euro apo 30%, subvencionet dhe transferet për 7.7 milionë euro apo 78% dhe shpenzimet e komunalive për 800 mijë euro apo 24%.

Figura 16. Shpenzimet buxhetore nga niveli lokal, mars-maj 2019-2020



BURIMI: INSTITUTI GAP DUKE PËRDORUR TË DHËNAT E MF

5. Pakot Fiskale Emergjente në Ballkanin Perëndimor dhe masat për rimëkëmbje

Shtetet fqinje të Kosovës, të cilat janë prekur po ashtu nga pandemia COVID-19, kanë ndërmarrë një numër masash si pjesë të pakove emergjente që të ndihmojnë ekonomitë e tyre.⁴³ Në këtë pjesë, do të bëjmë një përmbledhje të shkurtër lidhur me masat në vendet fqinje si dhe masat për rimëkëmbjen e sektorit privat në botë. Deri më tani, Qeveria e Kosovës e ka miratuar vetëm Pakon Emergjente Fiskale e cila përmban kryesisht masat afat-shkurta për adresimin e problemeve sociale të shkaktuar nga COVID-19. Kjo pako përfshin masa të tilla si: pagesa të dyfishta për skemat sociale, mbulimi i pagave për punëtorët e sektorit privat, subvencione të qirasë për biznese, shtesa për rrezik në paga të sektorit publik dhe privat, buxhet shtesë për komuna, kulturë, bujqësi, komunitete pakicë, sigurim i likuditetit financiar për ndërmarrje publike dhe private dhe masë për luftimin e informalitetit etj.⁴⁴ Sipas FMN-së, kjo pako në mënyrë të drejtë është e fokusuar në zbutjen e krizës tek bizneset dhe familjet si dhe krijon hapsirë për shpenzime në shëndetësi.⁴⁵

Masa të ngjashme janë ndërmarrë edhe në rajon.⁴⁶ Sic vërehet nga Aneksi 3, në Shqipëri janë paraparë masa sikurse ajo për ndarjen e rreth 88 milionë eurove për t'u mundësuar bizneseve likuiditet më të madh, si dhe ndarja e mbi 52 milionë eurove për mbulimin e pagave për punonjësit e bizneseve të ndikuar nga pandemia në vlerë të pagës minimale dhe dyfishimin e benefiteve të papunësisë dhe skemave të ndihmës sociale. Në Maqedoninë Veriore janë paraparë po ashtu masa emergjente sikur ajo për mbulimin e pagës minimale për punonjësit e bizneseve të ndikuara nga pandemia dhe përkrahja edhe për punonjësit që kanë qenë pjesë e ekonomisë jo formale. Po ashtu, është paraparë rritja e fondeve për bankat komerciale, në mënyrë që të nxitet aktiviteti i huazimit të bizneseve nga to.

Në Mal të Zi si masa fillestare janë aprovuar krijimi i një fondi kreditues me buxhet prej 120 milionë euro për të përmirësuar likuiditetin e bizneseve, dhënia e avanceve për punëkryesit e investimeve kapitale në sektorin publik si dhe pagesa e njëhershme shtesë prej 50 euro për të gjithë përfituesit e skemave sociale. Kurse, Serbia ka ndërmarrë një numër më të madh masash për të cilat ka ndarë rreth 3 miliardë euro. Ndër masat më të rëndësishme janë ato për transferin universal në kesh prej 100 Euro për të gjithë qytetarët mbi 18 vjeç që si masë kap vlerën prej mbi 594 milionë euro, nxitje të investimeve infrastrukturore në sektorin publik, garantim të kredive të NMV-ve tek bankat, mbulim të pagës minimale për punonjësit e NMV-ve, dhe më shumë.

43

44 Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 15, Burimi: <https://bit.ly/3gJl5dk>


45 FMN, Republic of Kosovo: Request for Purchase Under the Rapid Financing Instrument-Press Release; Staff Report; and Statement by the Executive Director for the Republic of Kosovo, Burimi: <https://bit.ly/3dzVdjh>

46 Masat e shtjelluara mëposhtë janë marrë nga databaza e FMN për politikat fiskale të shteteve si reagim ndaj pandemisë COVID-19. Burimi: <https://bit.ly/37fiSzK>

Këto shtete po prezantojnë në vazhdimësi edhe masa tjera fiskale varësisht nga identifikimi i nevojave të qytetarëve dhe bizneseve. Për më shumë, shumica e këtyre vendeve, duke përfshirë dhe Kosovën, janë duke dizajnuar masa fiskale për rimëkëmbje të ekonomive të tyre, ku vende si Mali i Zi veçse i kanë paraqitur ato. Ndërsa Kosova, bazuar në programin qeverisës 2020-2023, ka paraparë edhe një pako të dytë për Rimëkëmbje Ekonomike që do të aplikohet përgjatë viteve 2020-2021.⁴⁷

Në raport me madhësinë e ekonomive të tyre, madhësia e Pakove Fiskale Emergjente të miratuara nga këto vende del të jetë më e lartë në Serbi me rreth 7% të BPV, Kosova me 2.6% të BPV dhe Mali i Zi me 2.5% të BPV. Ndërsa, pako emergjente me vlerë më të ulët kishin miratuar Shqipëria me 1.4% të BPV, Maqedonia e Veriut me 1.2% të BPV dhe Bosnja e Hercegovina me 0.5% të BPV.

Figura 17. Pakot Fiskale Emergjente si përqindje e BPV në disa vende të Ballkanit Përqendror



BURIMI: INSTITUTI GAP DUKE PËRDORUR TË DHËNAT E FMN⁴⁸

Në programin qeverisës 2020-2023, Qeveria e Kosovës ka paraparë edhe një pako të dytë me anë të së cilës synon që brenda dy vitesh (2020-2021) të mobilizojë rreth 1.2 miliardë euro për rimëkëmbje ekonomike.⁴⁹ Mobilizimi i këtyre fondeve do të bëhet përmes masave të ndryshme që përfshijnë lehtësimin në financim, lirimet nga tatimet, mbështetje me subvencione për çështje të punësimit, mbështetje sektoriale për bujqësinë, rritjen e kërkesës agregate përmes kthimit të një përqindje për kontribut paguesit në Trustin Pensional dhe “greis” periudha për blerje të banesave/shtëpive etj. Për financimin e pakos së rimëkëmbjes pritet të ketë burime të ndryshme si nga kursimet buxhetore, financimi i brendshëm apo i jashtëm dhe ndihma buxhetore.

47 Qeveria e Kosovës. Programi Qeverisës 2021-2023

48 Shih Aneksin 3

49 Qeveria e Kosovës. Programi Qeverisës 2021-2023, Burimi: <https://bit.ly/2zshe4R>

Tabela 1. Masat për rimëkëmbje ekonomike

Masa dhe qëllimi	Nënmasa	Masa dhe qëllimi	Nënmasa
Lehtësimi i qasjes në financim /Lehtësimi i qasjes në kredi për ndërmarrjet private, për të financuar projekte investive dhe vazhdimin e operimit.	<p>a. Rritja e mbulueshmërisë së kredive të reja përmes Fondit për Garantimin e Kredive,</p> <p>b. Riprogramimi i kredive bankare ekzistuese, ku koston e riprogramimit të merr Qeveria,</p> <p>c. Subvencionimi i normave të interesit për sektorë të caktuar bazuar në një plan strategjik të përgatitur nga akterët relevantë.</p>	Masat për mbështetje të punësimit /Rritja e punësimit, në veçanti e grupeve specifike të punëtorëve me gjasa më të ulëta për punësim.	<p>a. Subvencionim i pagës për punëtorët në biznese të prekur nga pandemia,</p> <p>b. Subvencionim i pagës për punëtorët e rinj që marrin bizneset në punë bazuar në një plan që identifikon sektorët dhe kategorinë e punëtorëve më në nevojë,</p> <p>c. Përkrahja profesionale për biznese për funksionim në kushte pandemie, siç është puna nga shtëpia, puna online, transformimi digjital etj.</p>
